



PROCESVERBAL NGA KONSULTIMI PUBLIK LIDHUR
ME DRAFT RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E
BRENDSHËM, SISTEMATIZIMIN DHE KLASIFIKIMIN E
VENDEVE TË PUNËS NË KOMUNËN E RAHOVECIT

29.01.2026

Hapjen e takimit për Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Rahovecit e bëri Blerta Gashi, anëtare e grupit punues, e cila i uroi mirëseardhje të gjithë pjesëmarrësve, respektivisht zyrtarëve të komunës së Rahovecit.

Pas kësaj, ajo ia kaloi fjalën anëtarit të Grupit punues Mirsad Shala për një elaborim të punës së grupit në hartimin e kësaj rregulloreje.

MIRSAD SHALA: faleminderit Blerta. Atëherë, në fillim dua t'ju falenderoj të gjithë për pjesëmarrjen në këtë dëgjim publik për këtë rregullore e cila ka për qëllim sistematizim e vendeve të punës në Komunën e Rahovecit.

Ashtu siç jeni në dijeni shumica se, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil të Kosovës, në të cilin janë paraparë të gjitha pozitat që duhet ti ketë shërbimi civil me emërtimet, klasat, grupin dhe fushën e kërkuar të arsimimit. Pas kësaj, Kryetari i Komunës në nëntor të vitit 2024 ka caktuar grupin punues në përbërje prej 7 anëtarëve, për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Rahovecit, i cili grup ka bërë një punë 1 vjeçare për hartimin e kësaj rregulloreje.

Me të fillu punën si grup punues kemi mbajtur shumë takime, e një ndër takimet e para ka qenë informimi i drejtorave të drejtorive për këtë rregullore dhe njëherit kemi kërkuar nga të gjithë drejtorat e drejtorive dhe Zyra e Personelit identifikimin e të gjithë zyrtarëve publik dhe emërtimin e vendit të punës aktual në komunën e Rahovecit.

Pasi i kemi pranë propozimet e drejtorëve të drejtorive, të cilët kanë propozu për zyrtarët publik nën menaxhimin e tyre të ngriten nga një klasë, që dmth kush ka qenë në profesional 3 të bëhet profesional 2 dhe kush ka qenë në profesional 2 të bëhet në profesional 1 si dhe disa pozita specifike të inxhinjerëve dhe arkitektëve të bëhen specialistë. Në dakordim me kryetarin e komunës dhe drejtorin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z. Afrim Limani i cili e ka bërë të mundur me u realizukjo rregullore, pasi që i ka gjet mjetet dhe është miratuar buxheti për vitin 2026 me këto ndryshime.

Pas kësaj, jemi obligu me e dërgu draftin e parë të kësaj rregulloreje në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilët pas shqyrtimit na kanë dërgu disa rekomandime të lat në është dasht me i inkorporu në këtë rregullore, e realisht është dasht me ndryshu disa pozicione.

Në vijim po ju tregoj disa nga rekomandimet më të rëndësishme të cilat janë dhënë nga DMZP-ja:

- Si rekomandim i parë ka qenë që “Avokati i komunës” të vendoset dhe ti raportoj drejtëpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ.
- Pastaj rekomandimi tjetër është që “Zyrtari i Lartë Certifikues”, klasa profesional 1, Grupi i Ekonomisë duhet të vendoset dhe ti raportojë drejtëpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ dhe nuk mund të vendoset brenda sektorit apo drejtorisë komunale.
- Pastaj emërtimet si “zyra për...” etj mund të emërtohen “Sektori për...” në pajtim me rregulloren e qeverisë (QRK) Nr. 01/2020.
- Rekomandimi tjetër është që po citoj “gjatë përcaktimit të pozitave në kategorinë dhe klasën e specialistit, duhet pasur parasysh se nëpunësve aktual nuk mund të i'u ndryshohet kategoria aktuale në kategorinë e specialistit (përveç nëse janë duke e marrë pagën e specialistit), poashtu në kategorinë e specialistit nuk mund të sistemohen të punësuarit me diploma të drejtimeve arsimore”.

- Poashtu rekomandimi tjetër ka qenë që një zyrtar nuk mund të raportojë drejtpërdrejtë drejtorit të drejtorisë, por duhet ti raportojë udhëheqësit të sektorit.

Me këtë rastë, në drejtorinë për mbrojtje dhe Shpëtim kemi zyrtarin për emergjenca që i raporton drejtorit, kështu që në është dasht me e formu një sektor ku e kena parapa edhe një zyrtar tjetër, pasi që sektori mund të jetë i formun duke pas së pagu 2 zyrtar që janë pjesë e sektorit.

Gjithashtu, rekomandimi tjetër ka qenë se, disa emërtimet si zyrtar ligjor që janë të shpërndara nëpër drejtori duhet të vendosen tek sektori përkatës, repspektivisht sektori ligjor, por meqenëse ka disa zyrtar ligjor nëpër drejtori, e që me i pru në Zyrën Ligjore është e pamundur se është numri shumë i madh, dmth aktualisht janë 5 zyrtar ligjor opërfshi edhe udhëheqësin, ne kemi gjetë një emërtim pak më ndryshe në katalogun e evendeve të punës të qeverisë dhe i kemi emërtu si Zyrtar të lartë për mbështetje ligjore. Shpresoj që nuk kam harru diçka, po gjithsesi ne jemi ktu për me ju dhanë sqarime për të gjitha pyetjet e juaja të cilat i keni për këtë rregullore dhe pozicionin tuaj së bashk mu kryesuesin e grupit punues e njëherit udhëheqësin e Njesisë së Personelit Agron Thaqi. Faleminderit.

Gjatë dëgjimit publik lidhur me Draft Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Sistematizimin dhe Klasifikimin e Vendeve të Punës në Komunën e Rahovecit, i cili u mbajt më **29 janar 2026**, u parashtruan një sërë vërejtjesh dhe kërkesash nga zyrtarët pjesëmarrës.

Bjondina Ramaj Fazliu, Zyrtare e Lartë për Mbrojtje të Mjedisit në Sektorin për Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit, gjatë analizimit dhe shqyrtimit të Draft Rregullores në fjalë, përkatësisht për **Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit**, kam vërejtur se janë parashikuar tri (3) pozita pune, si në vijim:

1. **Pozita:** Udhëheqës i Sektorit
Klasa: Drejtues i ulët
Grupi: Inxhinieria e Ndërtimit
2. **Pozita:** Zyrtar i Lartë për Mbrojtje të Mjedisit
Klasa: Specialist
Grupi: Grupi i Përgjithshëm i Mjedisit
3. **Pozita:** Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit
Klasa: Profesional 2
Grupi: Planifikimi Hapësinor

Tek udhëheqësi i sektorit e kam vërejtë se grupi është i inxhinierisë dhe ndërtimit, e që në fakt mendoj se duhet të jetë grupi i planifikimit, njëjtë me emërtimin e pozitës. Faleminderit.

Mirsad Shala: faleminderit Bjondina. E kam lexu edhe emailin tuaj dhe të falenderoj për këtë korigjim. Besoj se kjo është gabim teknik nga ana jonë si grup pasi që, prej punës që e kemi bo kemi pas edhe gabime, kështu që pas kësaj ne do ta korigjojmë këtë pjesë në rregullore.

Po ashtu, z. **Beqir Hamza**, Zyrtar për Emergjenca, parashtrroi kërkesë që, nëse ekziston mundësia, në kuadër të **Sektorit për Emergjenca** të përfshihet edhe **pozita e punës “Zyrtar për Planifikim”** në këtë rregullore.

Mirsad Shala: Faleminderit Beqir, pasi që është dasht me e shtu edhe një pozitë të zyrtarit pasi e kena formu sektorin në drejtorinë tuaj, ne vetëm e kena shtu një pozitë me emërtimin e njëjtë. Por pasi ju mendoni se është më mirë të parashihet si pozitë e zyrtarit për planifikim në vend të zyrtarit për

emergjenca pasi e kemi një pozitë të zyratrit të lartë për emergjenca, atëherë ne do ta ndrshojmë këtë në momentin e parë. Faleminderit për propozimin dhe kontributin.

Ndërkaq, z. **Valmir Gashi**, Zyrtar Ligjor, parashtroi kërkesën që në **Zyrën për Përfaqësim** në rregullore të parashihet strukturë sektoriale, ku përveç **Avokatit Komunal**, të përfshihen edhe **Udhëheqësi i Zyrës** si dhe **dy (2) zyrtarë të tjerë**.

Mirsad Shala: Valmir, besoj se më keni ndëgju ë herët kur e përmenda se, DMZP-ja na ka dhanë disa rekomandime në draftin e dërguar tek ata për shqyrtim paraprak, e njëri prej tyre ka qenë se avokati komunal duhet ti jep llogari drejtëpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ e që është Kryetari i Komunës.

Gjithashtu, z. **Esat Hoti** parashtroi shqetësimin se, me këtë rregullore, i është ulur paga, me arsyetimin se deri më tani, bazuar në Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës, **pozita e Certifikuesit** ka qenë e barasvlershme me pozitën e **Udhëheqësit (Drejtues i Ulët)**, ndërsa sipas draftit të ri ajo kalon në **klasën Profesional 1**, çka përbën degradim në aspektin e pagës. Ai kërkoi që të gjendet një zgjidhje institucionale në mënyrë që të mos dëmtohet financiarisht.

Mirsad Shala: po Esat, ashtu siç e thash më herët nga rekomandimet e dhëna nga DMZP-ja, njëri ndër ta ishte edhe te pozita e Zyrtarit të lartë certifikues që duhet ti raportoj drejtëpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ, kështu që ne në fillim pozitën tuaj e kena parapa brenda drejtorisë me propozimin e drejtotrit, por nga DMZP na është kërku e e qit dhe me i raportu kjo pozitë drejtëpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ, e që kjo pozitë është rekomandu njopjt edhe në disa komuna të vendoset me i raportu drejtëpërdrejtë Zyrtarit Kryesor Administrativ. Ne si grup skemi qare pa i'u përmbajhtë këtyre rekomandimeve.

z. **Xhemajli Ejupi** parashtroi kërkesën dhe shqetësimin se, me këtë rregullore, **nuk i është ndryshuar koeficienti i pozitës së punës nga klasa Profesional 1 në klasën Specialist**, ndonëse, sipas tij, **i plotëson kriteret e përcaktuara** për këtë pozitë pune. Ai kërkoi që kjo çështje të rishqyrtohet dhe të bëhet harmonizimi i klasifikimit të pozitës me kualifikimin dhe përgjegjësitë përkatëse.

Mirsad Shala: i nderum, siç e thash më herët DMZP nuk na lejon që ne me i ndrshu këto klasa, dmth nga profesional në specialist. Po ta citoj atë çka na ka thënë DMZP-ja: gjatë përcaktimit të pozitave në kategorinë dhe klasën e specialistit, duhet pasur parasysh se nëpunësve aktual nuk mund të i'u ndryshohet kategoria aktuale në kategorinë e specialistit (përveç nëse janë duke e marrë pagën e specialistit), poashtu në kategorinë e specialistit nuk mund të sistemohen të punësuarit me diploma të drejttimeve arsimore.